

# D4D

Demokraci për Zhvillim



**PARA**  
dhe **PAS**

**PERFORMANCA E BAZUAR NË INDIKATORË:  
VLERËSIMI VJETOR  
2010**

Prishtinë  
Nëntor 2010

Demokraci për Zhvillim (D4D)

[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Copyright © 2010. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të D4D.

Ky projekt është përkrahur nga:



## Hyrje

Arsyeya kryesore pse ne u futëm në këtë projekt ishte pakënaqësia jonë me raportet 100 faqëshe të zyrtarëve të ndryshëm, kryesisht të mbushur me foto me ata që i kishin takuar gjatë 365 ditëve. A është kjo mënyra me e mirë e raportimit të përdorimit të taksave tona?

A është ulur niveli i sëmundjeve përgjatë viteve apo përmirësuar produktiviteti në punë? Ne kemi nevojë ti shohim këta numra në një mënyrë të thjeshtë. Ekzistojnë mundësi shumë më efikase për të monitoruar performancën e autoriteteve publike. Ne kemi dëshirë që të shohim progresin në jetën tonë në shumë aspekte (p.sh. sa shpejtë shkarkohet një dosje kompjuterike në kompjuterin tonë). Çfarë nëse do të mund të ishim në gjendje që ngjashëm të ndjekim progresin e institucioneve publike të cilat na i kemi zgjedhur për të shpenzuar taksat tona që i ndajmë me mund për çështjet publike. A nuk do të duhej të ishte e mundur që të përcjellim sa shpesh deputetët shkojnë në seanca?

Llogaridhënia më e madhe përmirëson funksionimin e përgjithshëm të qeverisjes si dhe kontribuon në pjesëmarrje më të madhe dhe demokraci. Për llogaridhënie më të madhe ka nevojë të vazhdueshme për të monitoruar performancën e qeverisë dhe agjencive publike të sektorëve të ndryshëm. Është e rëndësishme që një analizë e tillë publike është e thjeshtë dhe shoqëria mund të masë punën e tyre nga viti në vit.

Ky monitorim objektiv i performancës mundet që eventualisht të lehtësojë një rritje të presionit që vjen nga qytetarët, bizneset, shoqëria civile, media, opozita, partitë parlamentare dhe Kuvendi. Themelimi i një sistemi të informimit për të matur performancën e qeverisë në sektorët kryesorë është edhe më shumë i rëndësishëm për Kosovën ku praktikata e shpërndarjes së të dhënave janë të dobëta dhe qasja në të to në përgjithësi është e kufizuar.

Ky projekt ka të bëjë në përgjithësi me presionin konstruktiv dhe të bazuar në fakte nga shoqëria civile dhe publiku që janë mirë të informuar. D4D ka iniciuar krijimin e një sistemi të informimit që këtë herë ka matur 250 indikatorë në baza vjetore. Ndjekja e trendeve dhe matja e progresit shpie në

politikbërje të orientuar në rezultate që është larg më e mirë sesa nga ajo që ofrohet aktualisht Veçanërisht, D4D po ashtu shpreson që kjo ndihmon në instalimin e një kulture të vlerësimit të jashtëm dhe kontrollit nga publiku mbi politika, si dhe krijon pronësi të qeverisjes.

Ky publikim është i organizuar në katër pjesë: qeverisja, ekonomia, zhvillimi shoqëror dhe sundimi i ligjit. Secila pjesë është e ndarë në nën-pjesë që përfshijnë 5-10 indikatorë, tregon dallimin në mes të këtyre indikatorëve gjatë viteve të fundit dhe mat progresin e përgjithshëm. Krejt në fund, listat e burimeve të detaizuara janë të dhëna në fund të secilës pjesë për secilin indikator. Ne shpresojmë që këta indikatorë do të shërbejnë si bazë për matje të mëtutjeshme përgjatë viteve.

Në vend të raport-albumeve në fund të vitit, a nuk ju merr mendja që është më mirë të kemi një dokument të thjeshtë A4 me krahasime tabelare?

# EKONOMIA

## 1.1 Performanca Makroekonomike

		2008	2009	Dallimi	P
1.1.1	Shkalla e rritjes reale e GDP-së (%)	5.4	4	-1.5	▼
1.1.2	Shkalla e rritjes reale e GDP-së për kokë banori (%)	3.8	2.5	-1.3	▼
1.1.3	Eksportet (si % e GDP-së)	5.6	4.2	-1.4	▼
1.1.4	Importet (si % e GDP-së)	49	46.7	-2.3	▲
1.1.5	Bilanci Tregtar (si % e GDP-së)	-43.3	-42.5	-0.8	▲
1.1.6	Remitancat (si % e GDP-së)	13.9	13	-0.9	▼
1.1.7	Transferet Zyrtare të Jashtme (si % e GDP-së)	7.5	6.4	-1.1	▼
1.1.8	Bilanci i Llogarisë Rrjedhëse (si % e GDP-së)	-15.4	-16.2	0.8	▼
1.1.9	Investimet e Huaja Direkte (si % e GDP-së)	9.5	5.6	-3.9	▼

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Shkalla e rritjes ekonomike në prag të krizës ekonomike globale (krahasuar me 5,4% në vitin 2008) është rikthyer në rreth 4 për qind në vitin 2009. Ndikimi i rënies ekonomike u transmetua në Kosovë përmes një rënie të eksporteve, investimeve të huaja dhe remitancave, por ndikimi i përgjithshëm i krizës ka qenë i zbehtë për shkak të integritit të kufizuar ndërkombëtar të ekonomisë së Kosovës dhe rritjes së konsiderueshme në shpenzimet publike, veçanërisht në investime kapitale.

Në vitin 2009 në eksport ka rënie për 18 përqind, por pasi që në import ka më shumë rënie sesa në eksport në terma absolute deficiti i përgjithshëm i bilancit tregtar është përmirësuar disi.

Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës në vitin 2009 në flukset e investimeve të huaja ka rënie për mbi 20%.

Remitancat, kategoria e vetme më e madhe hyrëse në bilancin e pagesave, nuk ka dëshmuar ende rënie të ashpër; të dhënat paraprake tregojnë se rënia në vitin 2009 ka qenë nën 10 për qind.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## 1.2 Tregu i Punës dhe Varfëria

		2008	2009	Dallimi	P
1.2.1	Shkalla e Papunësisë (% e fuqisë punëtore)	47.4	45.4	-2	▲
1.2.2	Shkalla e papunësisë së rinisë (%)	73	73	0	=
1.2.3	Shkalla e papunësisë së femrave (%)	59.6	56.4	-3.2	▲
1.2.4	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	46	47.7	1.7	▲
1.2.5	Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore (%)	26.1	28.7	2.6	▲
1.2.6	Shkalla e punësimit (%)	24.1	26.1	2	▲
1.2.7	Regjistri publik i të papunësuarve (numër)	335,945	338,895	0.9%	▼
1.2.8	Shkalla e varfërisë absolute (%)	N/A	N/A		
1.2.9	Shkalla e varfërisë ekstreme (%)	N/A	N/A		

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Anketa e Fuqisë Punëtore e kryer nga Enti Statistikor i Kosovës tregon një rënie të vogël të normës së papunësisë nga 47.5 për qind në vitin 2008 në 45.4 për qind në vitin 2009 dhe në papunësinë e grave nga 59.6 përqind në 56.4 përqind.

Sondazhi i fundit gjithashtu tregon trend të rritjes në treguesit e shfrytëzimit të fuqisë punëtore si: shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (nga 46% në vitin 2008 në 47.7% në vitin 2009) si dhe shkalla e punësimit (nga 24.1% në 26.1%).

Në bazë të regjistrit publik, në dhjetor të vitit 2009 numri i përgjithshëm i të papunësuarve është rritur për 0.8 përqind. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se sistemi i regjistrit të papunësisë të Shërbimi Publik i Punësimit (SHPP) është i fryer (dhe për këtë arsye nuk është i besueshëm) nga një numër i lartë i njerëzve që nuk janë në mënyrë aktive duke kërkuar punë, ose janë duke punuar në sektorin joformal, ndërsa ka shumë të papunë të cilët nuk janë të regjistruar me SHPP.

Nuk ka të dhëna për nivelin e varfërisë për 2008 dhe 2009.

**Nota e përgjithshme: Përmirësim (▲)**

### 1.3 Stabiliteti Makroekonomik

		2008	2009	Dallimi	P
1.3.1	Bilanci Primar Buxhetor (si % e GDP-së)	-0.02	-0.68	-0.66	▼
1.3.2	Bilanci i Përgjithshëm (% e GDP-së)	0.0	-0.86	-0.86	▼
1.3.3	Borxhi i Qeverisë (si % e GDP-së)	N/A	6.8		
1.3.4	Pagesat e interesit (si % e GDP-së)	0.0	0.2	0.2	▼
1.3.5	Barra e taksave për ekonominë (si % e GDP-së)	21.6	21.1	-0.5	▲
1.3.6	Indeksi i çmimeve të konsumit (IQK) (Mesatarja %)	9.4	-2.4	-11.8	◀▶
1.3.7	IQK në fund të periudhës (%)	0.5	0.1	-0.4	◀▶
1.3.8	Deflatori i GDP-së (%)	7	-3.4	-10.4	◀▶

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

#### Komente mbi indikatorët:

Ekonomia nuk mund të rritet në një nivel të qëndrueshëm përveç nëse makro stabiliteti është i qëndrueshëm. Është njëkohësisht e vërtetë se vetëm stabiliteti makroekonomik nuk mjafton, megjithatë, konsiderohet se çrregullimet makroekonomike dëmtojnë ekonominë. Për shembull, qeveritë nuk mund të ofrojnë shërbime në qoftë se ato duhet të ndajnë një pjesë relativisht të rëndësishme të të ardhurave të tyre për pagesat e interesit dhe pagesat e borxhit publik apo deficiteve fiskale kufizojnë aftësinë e qeverive për të reaguar ndaj krizës.

Në vitin 2009 buxheti i përgjithshëm qeveritar ka shënuar një deficit për rreth 0.7% të GDP-së.

Të ardhurat fiskale janë rritur për 20,5% ose rreth €194.5 milion (nga €942.5 milion në vitin 2008 për tu rritur në €1136.7 milion në vitin 2009). Rritja i atribuohet kryesisht një pagese të dividendave jo-tatimore të ardhurat nga PTK-ja, ndërmarrja në pronësi publike në shumën prej €200 milion (ose 5% i GDP-së). Nga ana tjetër, në 2009 shpenzimet publike janë rritur në 20% ose rreth 188 milion € (nga €950.5 milion në vitin 2008 për në €1138.6 milion në vitin 2009). Rritje të rëndësishme janë regjistruar në të gjitha kategoritë e shpenzimeve publike.

Me që rritja e të ardhurave publike është si rezultat i një të ardhure jo tatimore (pagesat dividende nga PTK-ja), zgjerimi në shpenzime publike (duke përfshirë këto të ardhura dividende) do të paraqesin rrezik për stabilitetin afatmesëm fiskal dhe qëndrueshmërinë e financave publike.

Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2009 ishte -2,4 përqind. Megjithatë për shkak të rritjes së çmimeve të naftës dhe të transportit në dhjetor të vitit 2009 në bazë vjetore IQK është rritur me 0.1%.

**Nota e përgjithshme:** Përkeqësim (▼)



## 1.4 Zhvillimi i Sektorit Financiar

		2008	2009	Dallimi	P
1.4.1	Asetet Bankare (% e GDP)	46.9	56.9	10	▲
1.4.2a	Asetet e huaja neto (në mil. Euro) -nga e cila depozita dhe letra me vlerë (në milion Euro)	1,593	1700	6.7%	▼
1.4.2b		1,456	1,634.4	12.2%	
1.4.3	Depozitat (% e GDP)	37.52	45.11	7.6	▲
1.4.4	Rritja vjetore e depozitave (%)	26.3	20.8	-5.5	▼
1.4.5	Kreditë (% e GDP)	30.75	33.32	2.6	▲
1.4.6	Norma vjetore e rritjes së kredisë (%)	32.6	8.9	-23.7	▼
1.4.7	Shpërndarja e interesit	9.4	10.1	0.7	▼
1.4.8	Shkala e kredive të këqija	3.3	4.3	1	▼
1.4.9	Kthime nga asetet mesatare (%)	2.6	1.3	-1.3	▼
1.4.10	Kthimi nga kapitali mesatar (%)	26.6	13.2	-13.4	▼
1.4.11	Raporti kredi/depozita (%)	82	74	-8	▼
1.4.12	Raporti i aseteve likuide ndaj aseteve totale (%)	30.7	32.3	1.6	▲

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Një sektor financiar efikas alokon burimet për përdorim më produktiv ose të projekteve investive me norma më të larta të kthimit. Zgjerimi i tregjeve financiare siguron mjete të mëdha financiare për konsum dhe investim (kërkesa agregate) të cilat si pasojë e nxisin rritjen ekonomike.

Në dhjetor 2009, shuma e depozitave në sektorin bankar arriti në €1.745 milion, që paraqet një rritje vjetore prej 21 për qind e cila është më e ulët se norma e rritjes vjetore prej 26.3 përqind të regjistruar në dhjetor 2008.

Në anën tjetër, në dhjetor të vitit 2009, kreditë totale të sektorit bankar arritën shumë prej €1,289 milionë, duke përfaqësuar një rritje vjetore prej vetëm 9 për qind në krahasim me 32,5 përqind në vitin 2008. Shkalla e ulët të rritjes në kredi automatikisht do të ngadalësojë ritmin e rritjes së kërkesës agregate, si dhe nivelin e investimeve dhe në këtë mënyrë edhe GDP potencial.

Çuditërisht, edhe pse norma vjetore e rritjes së depozitave dhe kredive ka rënë gjatë

vitit 2009, shpërndarja e interesit midis kredive dhe depozitave është rritur gjatë kësaj periudhe.

Një tregues i tjetër rëndësishëm për efikasitetin e sektorit bankar janë portfoliot e kredive të këqija. Portofoli i kredive të këqija është rritur nga 3,3% (në fund të vitit 2008) në 4.3% (në fund të 2009).

**Nota e përgjithshme:** Përkeqësim (▼)

## 1.5 Korniza Rregulative për Biznes

		2008	2009	Dallimi	P
1.5.1	Lehtësia e të bërit biznes (renditja)	107	113	-6	▼
1.5.2	Fillimi i një biznesi (renditja)	156	164	-8	▼
1.5.3	Përpjekja për marrjen e lejes së ndërtimit (renditja)	173	176	-3	▼
1.5.4	Punësimi i punëtorëve (renditja)	32	34	-2	▼
1.5.5	Regjistrimi i pasurisë (renditja)	60	68	-8	▼
1.5.6	Marrja e kredisë (renditja)	41	43	-2	▼
1.5.7	Mbrojtja e investitorëve (renditja)	171	172	-1	▼
1.5.8	Pagesa e taksave (renditja)	49	50	-1	▼
1.5.9	Tregti përtej kufirit (renditja)	129	132	-3	▼
1.5.10	Zbatimi i kontratave (renditja)	156	157	-1	▼
1.5.11	Mbyllja e biznesit (renditja)	28	28	0	=

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Korniza ligjore dhe rregullative, si dhe sjelljet institucional brenda të cilave bizneset, individët dhe qeveria e bashkëveprojnë ndikon në vendimet për investime dhe organizimin e prodhimit. Indikatorët e të Bërit Biznes sigurojnë matjen objektive të rregullave të biznesit dhe zbatimin e tyre. Kjo renditje fokusohet në 10 tema, me qëllim të matjes së rregullores dhe të burokracisë në lidhje me ciklin e jetës së një biznesi vendor (të vogël dhe të mesëm). Raporti krahason rregulloret për fillimin e një biznesi, marrjen e lejes së ndërtimit, punësimin e punëtorëve, regjistrimin e pasurisë, marrjen e kredisë, mbrojtjen e investitorëve, pagesën e taksave, tregtinë përtej kufirit, zbatimin e kontratave dhe mbylljen e një biznesi si dhe zbatimin e tyre për ndërmarrjet të vogla dhe të mesme. Sipas Raportit "Të bësh biznes" të Bankës Botërore të botuar në vitin 2010 duke përdorur të dhënat nga viti 2009, Kosova u rendit në vendin e 113 (vitin e kaluar në vendin 107). Rënditja e ulët në indeksin e lehtësive të të bërit biznes do të thotë se mjedisi rregullativ nuk është i favorshëm.

Pozicioni i përkeqësuar nuk është si rezultat i masave të politikave të pafavorshme të ndërmarra në 2009, por më tepër si rezultat i faktit që asgjë nuk ka ndryshuar në këto fushat gjatë kësaj periudhe dhe vende të tjera kanë marrë iniciativa për përmirësimin e këtyre treguesve. Rënditja e Kosovës u përkeqësua në të gjitha nën-treguesit me përjashtim të "mbylljes së një biznesi". Rënie më të lartë është vërejtur në "fillimin e një biznesi". Për më tepër, indikatorët që kanë të bëjnë me lejet e ndërtimit, mbrojtjen e investitorëve, dhe zbatimin e kontratës u janë renditur si mjaft të dobët.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## 1.6 Energjia

		2008	2009	Dallimi	P
1.6.1	Prodhimi i thëngjillit (tona)	7,842,000	7,870,727	0.4%	▲
1.6.2	Prodhimi i Energjisë Elektrike (mega watt orë)	4,528,100	4,680,000	3.35%	▲
1.6.3	Konsumi i energjisë (mega watt orë)	2,940,900	3,200,674	8.5%	▲
1.6.4	Importi i energjisë elektrike (mega watt në orë)	647,500	610,509	- 5.7%	▼
1.6.5	Eksporti i energjisë elektrike (mega watt në orë)	235,000	113,910	- 51.5%	▼
1.6.6	Bilanci Tregtar (mega watt orë)	-412,500	-496,599	20.4%	▼
1.6.7	Humbjet (në %)	44.1	35.45	- 9	▲
1.6.8	Inkasimi (në mil. Euro)	134.6	160	18%	▲
1.6.9	Inkasimi si % e energjisë së faturuar (%)	76	81	5	▲
1.6.10	Inkasimi i energjisë së përgjithshme në dispozicion (%)	61	64	3	▲
1.6.11	Mesatarja ndërprerjeve në furnizimin e energjisë elektrike				

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Zhvillimi i mirë i infrastrukturës është kusht thelbësor për zhvillimin ekonomik si dhe faktor i rëndësishëm për përcaktimin e lokacionit dhe sektorët që mund të zhvillohen.

Trende pozitive janë vërejtur në shumë tregues që lidhen me energji elektrike, si në prodhimin e thëngjillit, importet e energjisë elektrike si dhe në humbje të energjisë elektrike dhe inkasimin e energjisë totale në dispozicion.

Megjithatë, pavarësisht nga tendencat pozitive të vërejtura në shumë tregues të energjisë elektrike, nuk është vërejtur asnjë përparim në projektin e Termocentralit Kosova e Re, në Hidrocentralin e Zhurit apo projekteve më të vogla të energjisë hidrike.

**Nota e përgjithshme: Përmirësim (▲)**

## 1.7 Infrastruktura - Transporti dhe Telekomunikacioni

		2008	2009	Dallimi	P
1.7.1	Rrjeti rrugor (kryesor + rajonal, km)	1925,1	1925,1	0	=
1.7.2	Përpjesëtimi për rrugë paasfaltuar në të asfaltuar	15.5	15.4	0.1	=
1.7.3	Trafiku i pasagjerëve me hekurudha	399,221	374,504	-6.2%	▼
1.7.4	Trafiku i mallrave (neto tona)	823,045	911,830	10.8%	▲
1.7.5	Numri i fluturimeve të kryera	4,828	5,709	18.25%	▲
1.7.6	Gjithsej udhëtarë (aeroplan)	1,130,639	1,191,978	5.4%	▲
1.7.7	Linjat fikse telefonike (vetëm PTK)	78,869	88,877	12.7%	▲
1.7.8	Abonimet Telefonike Mobile	1,159,950	1,463,609	26.2%	▲
1.7.9	Përdoruesit e internetit	110,879	125,949	13.6%	▲
1.7.10	Broadband Internet abonimet (vetëm IPKO dhe PTK)	93,847			

Performanca (P); Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komentet mbi indikatorët:

Derisa trende pozitive janë vërejtur në të trafikut ajror dhe hekurudhat e trafikut të mallrave, trende negative janë vërejtur në trafikun hekurudhor të pasagjerëve.

Është interesante të vërehet se rritja e projekteve infrastrukturore të rrugëve nuk është përfshirë në statistika zyrtare. Duke u bazuar në statistikat e publikuara nga Enti i Statistikor i Kosovës nuk ka ndryshime në rrjet të rrugës dhe në raportin me rrugë të pa asfaltuar në të asfaltuara.

Përdorimi i infrastrukturës telekomunikuese është përmirësuar edhe gjatë vitit 2009 kryesisht për abonimet fikse dhe mobile, si dhe për përdoruesit e internetit, ndërsa për abonimet broadband nuk ka të dhëna për vitin 2009.

**Nota e përgjithshme: Përmirësim (▲)**

## Aneks: Indikatorët dhe burimet

	Indikatorët	Burimet
<b>1.1 Performanca Makroekonomike</b>		
1.1.1	Shkalla e rritjes reale e GDP-së (%).	FMN. Raport mbi Kosovën Nr. 10/246, Korrik 2009
1.1.2	Shkalla e rritjes reale e GDP-së për kokë banori (%).	
1.1.3	Eksportet (si % e GDP-së).	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Buletini i Bilancit të Pagesave, Nr 9, 2010
1.1.4	Importet (si % e GDP-së).	
1.1.5	Bilanci Tregtar (si % e GDP-së).	
1.1.6	Remitancat (si % e GDP-së).	
1.1.7	Transferet Zyrtare të jashtme (si % e GDP-së).	FMN. Raport mbi Kosovën Nr. 10/246, Korrik 2009
1.1.8	Bilanci i Llogarisë Rrjedhëse (si % e GDP-së).	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Buletini I Bilancit të Pagesave, Nr 9, 2010
1.1.9	Investimet e Huaja Direkte (si % e GDP-së).	
<b>1.2 Tregu i Punës dhe Varfëria</b>		
1.2.1	Norma (shkalla) e Papunësisë (% e fuqisë punëtore).	Enti i Statistikës së Kosovës. Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2009
1.2.2	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%).	
1.2.3	Shkalla e papunësisë së femrave(%).	
1.2.4	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, ndarja e fuqisë punëtore (të punësuar dhe të papunësuar) në popullsinë e përgjithshme në moshë pune, (%).	
1.2.5	Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore (%).	
1.2.6	Shkalla e punësimit, numri i përgjithshëm i të punësuarve të ndarë për popullsinë në moshë pune (16-65) (%).	
1.2.7	Regjistri publik i të papunësuarve.	

		Sociale. Puna dhe Punësimi, Raport Vjetor 2009.
<b>1.3 Stabiliteti Makroekonomik</b>		
1.3.1	Bilanci primar (Parësor) buxhetorë (si % e GDP-së).	Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Pasqyrë Makroekonomike, Prill 2010.
1.3.2	Bilanci I përgjithshëm, bilanci primar buxhetor plus pagesat e interesit (si % e GDP-së).	
1.3.3	Borxhi i Qeverisë (si % e GDP-së).	FMN. Raport mbi Kosovën Nr. 10/246, Korrik 2009.
1.3.4	Pagesat e interesit (si % e GDP-së)	FMN. Raport mbi Kosovën Nr. 10/246, Korrik 2009
1.3.5	Barra e taksave për ekonominë (si % e GDP-së)	Llogaritja jonë
1.3.6	Indeksit të Qmimeve të Konsumit (IQK), Mesatarja e (%).	Enti i Statistikave të Kosovës. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (2002-2009), Qershor 2010.
1.3.7	IQK në fund të periudhës (%).	
1.3.8	Deflatori GDP (%), është një masë e nivelit të çmimeve të të gjitha të reja, të prodhuar në vend, mallrave dhe shërbimeve përfundimtare në një ekonomi.	FMN, Raport mbi Kosovën Nr. 10/246. Korrik 2009
<b>1.4 Zhvillimi i Sektorit Financiar</b>		
1.4.1	Asetet Bankare (% e GDP).	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Bulletini Mujor Statistikor, Maj 2010
1.4.2a 1.4.2b	Asetet e huaja neto (në milionë €), vlera e aseteve që një vend zotëron jashtë vendit, minus vlerën e mjeteve të brendshme në pronësi të të huajve. ... e cila depozitave dhe letrave me vlerë (në milionë €).	
1.4.3	Depozitat (% e GDP).	
1.4.4	Rritja vjetore e depozitave.	
1.4.5	Kreditë (% e GDP).	

1.4.6	Norma vjetore e rritjes së kredisë.	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Buletini për Sektorin Financiar, 2010	
1.4.7	Shpërhapja e interesit (Interest Spread-s).		
1.4.8	Shkalla e kredivete këqija i referohet raportit të kredive me probleme (NPL-kredive që janë në mungesë apo afër për të qenë në mungesë) në totalin e kredive.		
1.4.9	Kthimi nga Aktivet Mesatare (ROAA), raporti në mes të pas tatimit mbi fitimin dhe aktivet mesatare.		
1.4.10	Kthimi nga kapitali mesatar (RoAE), raporti ndërmjet pas tatimit mbi fitimin dhe kapitali mesatar.		
1.4.11	Kredi për depozitat (%).		
1.4.12	Raporti i asetëve likuide ndaj asetëve totale (%), ajo është pjesë e konvertueshme e aktiveve të bankës: është raporti i totalit të aktiveve të gatshme të konvertueshme në para të gatshme.		
<b>1.5 Kuadri Regulator për Biznes</b>			
1.5.1	Pozicionimi i të Bërit Biznes lehtë, është një përmbledhje e 10 treguesve më poshtë.		Banka Botërore. Të Bërit (Bësh)Biznes 2010, Reforma gjatë Kohëve të Vështira
1.5.2	Fillimi i biznesit varet nga numri i procedurave, koha (ditë), kostoja minimale e kapitalit të kërkuar		
1.5.3	Përpjekja për marrjen e lejes së ndërtimit, varet nga numri i rregullave, koha (ditë) dhe kostoja gjatë marrjes së lejes së ndërtimit.		
1.5.4	Punësimi i punëtorëve varet nga rregullat e punësimit dhe shkarkimit të shoqëruara me kosto.		



1.5.5	Renditja e regjistrimit të pronës, varet nga numrin e procedurave, koha (ditë) dhe kostoja e regjistrimit.	
1.5.6	Marrja e kredisë shikon sforcimin e të drejtave ligjore, thellësia e informatave për kreditë dhe mbulueshmëria e regjistrit kreditor.	
1.5.7	Mbrojtja e investitorëve shikon shkallën e deklarimit, lehtësia e padive nga hisenikët etj.	
1.5.8	Pagesa e taksave merret me numrin e pagesave, kohën dhe shkallën e tërësishme të tatimit.	
1.5.9	Tregtimi përtej kufinjve shikon numrin e dokumentave, kohën (ditët) dhe koston e eksport/importit.	
1.5.10	Implementimi i kontratave mat procedurat, kohën dhe koston e kërkesave.	
1.5.11	Mbyllja e bizneseve mat kohën, koston dhe shkallën e rikthimit.	
<b>1.6 Energjia</b>		
1.6.1	Prodhimi i Thëngjillit (tona)	Enti i Statistikës së Kosovës. Bilanci i Energjisë në Kosovë (TM 4 2009).
1.6.2	Prodhimi i Energjisë Elektrike (mega watt orë).	
1.6.3	Konsumi I Energjisë (mega watt orë).	
1.6.4	Importi i energjisë elektrike (mega watt në orë).	Enti i Statistikës së Kosovës. Bilanci i Energjisë në Kosovë (TM 4 2009).
1.6.5	Eksporti i energjisë elektrike (mega watt orë).	
1.6.6	Bilanci Tregtar (mega watt në orë).	
1.6.7	Humbjet (në %).	

1.6.8	Inkasimi (në mil. Euro).	
1.6.9	Inkasimi si % e energjisë së faturuar (%).	
1.6.10	Inkasimi i energjisë së përgjithshme në dispozicion (%).	
1.6.11	Mesatarja ndërprerjeve në furnizimin e energjisë elektrike.	
<b>1.7 Infrastruktura - Transporti dhe Telekomunikacioni</b>		
1.7.1	Rrjeti rugor (kryesor + rajonal, km).	
1.7.2	Raporti për rrugë paasfaltuar në të asfaltuar.	Enti i Statistikës së Kosovës, Kosovë në Shifra 2009, Prill 2010.
1.7.3	Trafiku i pasagjerëve.	Hekurudhat e Kosovës Sha,
1.7.4	Trafiku i mallrave (net tona).	Raporti Vjetor 2009, Janar 2010.
1.7.5	Numri I fluturimeve të kryer.	Enti i Statistikës së Kosovës,
1.7.6	Gjithsejt udhëtarë.	Kosovë në Shifra 2009, Prill 2010.
1.7.7	Linjat fikse telefonike (vetëm PTK).	PTK Raporti Vjetor për 2009.
1.7.8	Abonimet Telefonike Mobile.	PTK dhe IPKO Raportet Vjetore për 2009.
1.7.9	Përdoruesit e internetit.	ART Raporti Vjetor për 2009.
1.7.10	Broadband Internet abonimet (vetëm IPKO dhePTK).	PTK dhe IPKO Raportet Vjetore për 2009.

## 2. QEVERISJA

## 2.1 Qeverisja

		2008	2009	Dallimi	P
2.1.1	Shërbimi civil (numri)	75,474	78,673	3,199 (4.2%)	▼
2.1.2	Qeverisja Demokratike Kombëtare (Indeks FH)	5.50	5.25	-0.25	▲
2.1.2	Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës/Terrorizmit (Indeks i BB)	-0.69	-0.68	-0.1	▲
2.1.3	Efektiviteti i Qeverisë (Indeks i BB)	-0.74	-0.5	- 0.24	▲
2.1.4	Kënaqshmëria me Qeverinë (%)	47/49/5 7	38/53/5 6	-9/+4/-1	▼
2.1.5	Kënaqshmëria me Kryetarin (%)	73/69/7 0	47/61/6 1	-26/-8/- 9	▼
2.1.6	Kënaqshmëria me Kryeministrin (%)	71/63/6 3	40/53/5 2	-29/- 10/-11	▼

Performanca (P): Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Përkundër kundërshtimit nga ana e Fondit Ndërkombëtar Monetar, shërbimi civil kosovar ka pësuar rritje. Freedom House dhe Banka Botërore kanë raportuar përmirësim modest në indikatorët e qeverisjes, që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me perceptimin publik që ka shënuar rënie drastike dhe të paparë më herët.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## 2.2 Kuvendi i Kosovës

		2008	2009	Dallimi	P
2.2.1	Interpelanca	3	0	-3	▼
2.2.2	Pyetjet Parlamentare	250	224	-26 (-10%)	▼
2.2.3	Miratimi i ligjeve (numër)	91	37	-54 (-60%)	▼
2.2.4	Vijueshmëria e deputetëve në seanca parlamentare (mesatarja)	99.5	99	-0.5	▼
2.2.5	Kënaqshmëria me Kuvendin (%)	46-49	53-46	0	=

Performanca (P): Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Kuvendi i Kosovës del të jetë një nga tregimet më dëshpëruese nga 2008 në 2009. Përveç rrogave dhe pensioneve të tyre, duket se janë brengosur për fare pak gjëra tjera.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## 2.3 Zgjedhjet dhe Partitë Politike

		2008	2009	Dallimi	P
2.3.1	Dalja në zgjedhjet ... ... kombëtare	49.5% (2004)	40.1% (2007)	9.4%	▼
2.3.2a 2.3.2b	... komunale (%) (Kuvend/ Kryetar)	39.4/39.5 (2007)	45.4/44.7 (2009)	3.9/5.2	▲
2.3.3	Vëzhgues (numër)	27,000	19,576	- 7,426 (-27.5%)	▼
2.3.4	Renditja e procesit zgjedhor (FH)	4.5	4.5	0	=
2.3.5	Kostoja e administrimit të zgjedhjeve për votues (Euro)	4.16 (2007)	4.97 (2009)	0.81	▼
2.3.6	Fondi i Demokratizimit (Euro)	1,913,783	1,911,783	-2,000 (-0.1%)	▲
2.3.7	Partitë Parlamentare (numër)	18 (2004- 2007)	18 (2007- 2010)	0	=

**Performanca (P):** Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Rënia e daljes në zgjedhje kombëtare nga viti 2004 në 2007 është ndjeshëm më e theksuar sesa rritje e daljes në ato lokale. Numri i vëzhguesve gjithashtu ka rënë që e ul transparencën. KQZ ka zbatuar zgjedhje gjithnjë e më të shtrenjta, dhe nga viti 2008 në 2009 kemi vërejtur rritje të koston së administrimit të zgjedhjeve për më tepër se 20%. Fondi i Demokratizimit (alokim nga buxheti i Kosovës për grupet parlamentare) qëndron në nivel të njëjtë si më herët ashtu si edhe numri i grupeve parlamentare. Në shkallë nga 1 deri në 7, Freedom House ka vlerësuar zgjedhjet si më parë, me një notë dëshpëruese prej 4.5 (1 paraqet nivelin më të lartë të përparimit demokratik dhe 7 më të ulët).

**Nota e përgjithshme:** Përkeqësim (▼)

## 2.4 Qeverisje Lokale dhe Decentralizimi

		2008	2009	Dallimi	P
2.4.1	Shkalla e inkasimit të tatimit në pronë	8.2 mln (2007)	12.7 mln (2008)	53%	▲
2.4.2	Të ardhurat vetanake komunale (mln Euro)	38.3	37.2	-1.1 (-2.87%)	▼
2.4.3	Qeverisja lokale demokratike (Indeks FH)	5.50	5.25	-0.25	▲
2.4.4	Komunat (numër)	30	37	8	▲
2.4.5	Transferi i kompetencave (niveli)	N/A	15/10/3		
2.4.6	Buxheti mesatar komunal	7,166,510	7,375,758	209,248 (2.92%)	▲
2.4.7	Të hyrat vetanake (si përqindje e buxhetit total)	19.8%	15.2%	-4.6%	▼
2.4.8	Shkalla e përfaqësimit (raporti votues/këshilltar)	1,545	1,547	2	▼

**Performanca (P):** Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Nuk është inkurajuese që të ardhurat vetanake kanë shënuar rënie prej 1.1 mln eurove nga viti 2008 në 2009. Në të njëjtën kohë, rënia e të ardhurave vetanake si përqindje e buxhetit total është më e ashpër për shkak të rritjes së granteve qendrore ndaj komunave. Kjo reflekton një rënie të theksuar të të ardhurave vetanake si përqindje e totalit (afër një e treta). Freedom House ka vërejtur një përparim të butë në qeverisje lokale. Është logjike të pritet që përfaqësimi do të përmirësohet me krijimin e shtatë komunave të reja, mirëpo rritja e këshilltarëve komunal nga komunat e reja u kompenzua nga reduktimi i këshilltarëve kryesisht në komunat 'amë'.

**Nota e përgjithshme: Përmirësim (▲)**

## 2.5 Raportet ndër-etnike dhe kthimi

		2008	2009	Dallimi	P
2.5.1	<b>Distanca e perceptuar ndër-etnike</b> (Gatishmëria e serbëve dhe shqiptarëve që të punojnë mes vete)	Serbëve: 29% Shq: 46.5%	Serbëve: 27% Shq: 39.5%	-2 -7	▼
2.5.2a 2.5.2b	<b>Përbërja e Policisë së Kosovës</b> (Serbë/Komunitete tjera)	10%/ 5.52	9.92%/ 5.49%	-0.08% / 0.03	▼
2.5.3a 2.5.3b	<b>Serbët/Komunitetet tjera në sektorin publik</b>		5.21%/ 3.64%		
2.5.4	<b>Kthimi vullnetar</b>	2,382	3,544	1,162 (49%)	▲
2.5.5	<b>Kthimi i detyruar</b>	2,550	2,962	412 (16%)	▼
2.5.6	<b>Krime ndër-etnike</b> (numër)		82		

**Performanca (P):** Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Përkundër rezultateve në projektet madhore si decentralizimi, distanca ndër-etnike është rritur. Kthimi ka shënuar rritje, por për fat të keq ka shënuar rritje dhe kthimi i detyruar. Përfaqësimi i serbëve në Policinë e Kosovës ka rënë, përderisa ka pak të dhëna për përfaqësimin e tyre në institucionet tjera.

**Nota e përgjithshme:** Përkeqësim (▼)



## 2.6 Media

		2008	2009	Dallimi	P
2.6.1	Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias (IREX)	2.26	2.38	0.12	▲
2.6.2	Fjala e lirë	2.33	2.37	0.04	▲
2.6.3	Gazetaria profesionale	2.24	2.23	-0.01	▼
2.6.4	Pluralizmi i burimeve të lajmeve	2.40	2.59	0.19	▲
2.6.5	Menaxhimi i biznesit	1.96	2.40	0.44	▲
2.6.6	Instit. përkrahëse	2.39	2.32	-0.07	▼
2.6.7	Numri i shtëpive mediale: shtyp/radio/tv	8/95/21	9/92/22	1/-3/1	▲
2.6.7	Mediat e pavarura (FH index)	5.50	5.50	0	=
2.6.8	Indeksi i lirisë së shtypit (FH)		53		
2.6.9	Ambienti ligjor		15		
2.6.10	Ambienti politik		20		
2.6.11	Ambienti ekonomik		18		
2.6.12	Indeksi i lirisë së shtypit (RSF)	12,00	16,58	4.58	▼

Performanca (P): Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

IREX vërejt një përmirësim të butë në qëndrueshmërinë e medias. Edhe në 2008 edhe në vitin 2009, Kosova ishte në kategorinë e 'afër qëndrueshmërisë' (2-3), por më afër kategorisë 'sistem miks i paqëndrueshëm' (1-2) sesa kategorisë 'qëndrueshëm' (3-4). Një gazetë dhe një stacion televiziv i janë shtuar spektrit medial në Kosovë, përderisa tri radio stacione kanë pushuar së punuari. Freedom House e renditi pavarësinë e mediave njësoj si në 2008, përderisa renditi lirinë e shtypit në Kosovë për herë të parë. Gazetarët pa Kufinj vlerësuan se liria s shtypit ka pësuar rënie të ndjeshme.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## 2.7 Shoqëria Civile

		2008	2009	Dallimi	P
2.7.1	Indeksi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile	3.9	3.9	0	=
2.7.2	Ambienti ligjor	3.4	3.5	0.1	▼
2.7.3	Kapaciteti organizativ	3.7	3.7	0	=
2.7.4	Qëndrueshmëria financiare	4.7	4.8	0.1	▼
2.7.5	Avokimi	3.9	3.8	-0.1	▲
2.7.6	Ofrimi i shërbimeve	4.0	3.9	-0.1	▲
2.7.7	Infrastruktura	3.5	3.6	0.1	▼
2.7.8	Imazhi publik	3.8	3.7	-0.1	▲
2.7.9	Perceptimi i korrupsionit të OJQ-ve (%)	10	18	8	▼
2.7.10	Renditja e shoqërisë civile (Indeksi i FH)	4.00	4.00	0	=
2.7.11	Numri i OJQ-ve vendore të regjistruara	3,800	5,000	1,200 (31.6%)	▲
2.7.12	Vlerësimi për nivelin e Demokracisë	5.21	5.11	-0.10	▼

**Performanca (P):** Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼)

### Komente mbi indikatorët:

Indeksi i Qëndrueshmërisë së OJQ-ve përfshin edhe indikatorët më poshtë. Indeksi prej 3.9 dtth që shoqëria civile në Kosovë është në nivel të tranzicionit të mesëm (3-5). Për fat të keq nuk është duke përparuar drejt konsolidimit (1-3) dhe për dy vite me radhe është notuar me të njëjtën notë. Është shënuar një rritje e personave që e shohin shoqërinë civile si të korruptuar. Numri i OJQ-ve është rritur por kjo nuk ka ngritur renditjen e Freedom House (4 në shkallë nga 1-7) ku 1 shënon nivelin më të lartë të zhvillimit demokratik dhe 7 atë më të ulët. Vlerësimi për nivelin e demokracisë është një renditje që nxjerr mesataren, që në këtë rast thekson rënie.

**Nota e përgjithshme: Përkeqësim (▼)**

## Shtojca: Indikatorët dhe burimet

	Indikatorët	Burimet
<b>2.1 Qeverisja</b>		
2.1.1	Shërbimi civil (numri).	MEF. Vlerat janë nxjerrë nga buxhetet e Kosovës për vitet 2008 dhe 2009.
2.1.2	Qeverisja Demokratike Kombëtare (Indeks FH).	Freedom House. Kombet në Tranzicion.
